



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime
 - * Aktivitetet tjera

Shkurt 2018

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Krimi i organizuar

Më 01 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temën “Krimi i organizuar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i



njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në zbatimin e drejtë të dispozitave të Kodit Penal me të cilat janë sanksionuar veprat penale që ndërlidhen me krimin e organizuar si dhe problemet të cilat paraqiten në praktik me qëllim që të zbatohen në mënyrë unike dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë këtij trajnimi u trajtua krimi i organizuar

si formë e kriminalitetit që kryhet nga një grup personash të strukturuar dhe të organizuar me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt ose tërthorazi të dobisë financiare. Krimi i organizuar kërcënon seriozisht zhvillimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit.

Vëmendje parësore, iu kushtua parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit të krimit të organizuar që në pjesën dërmuese të rasteve kjo veprë penale është e ndërlidhur edhe me vepra tjera penale si trafikimi me qeneje njerëzore, veprat penale kundër ekonomisë, kontrabandimi me mallra, veprat penale të narkotikëve etj.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë të nivelit themelor dhe nivelit të apelit, prokurorë të nivelit themelor, prokurorë nga PSRK si dhe bashkëpunëtor profesional.



Trajnim hyrës lidhur me krimin kibernetik, provat elektronike dhe përfitimet ilegale nga krimet online

Më 07-10 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me projektin BE-së, të zbatuar nga Këshilli i Evropës / iPROCEEDS, ka realizuar trajnimin me temë “Trajnim hyrës lidhur me krimin kibernetik, provat elektronike dhe përfitimet ilegale nga krimet online”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve për natyrën dhe implikimet dëshmuuese të çështjeve të krimit kibernetik, të kontrollit, sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave të krimit online, si edhe instrumentet e disponueshme ligjore dhe qasjet ndaj bashkëpunimit ndërkombëtarë.

Në fokus të trajnimit ishin dispozitat materiale dhe procedurale të Konventës së Budapestit për Krimin Kibernetik dhe akte tjera ndërkombëtare, duke i përfshirë edhe dispozitat ligjore të Kosovës që sanksionojnë krimin kibernetikë.

Po ashtu, gjatë trajnimit vëmendje iu kushtua provave elektronike dhe të ardhurave nga krimi kibernetik të cilat janë komplekse, dhe se për të qenë të suksesshëm duhet një bashkëpunim i të gjitha institucioneve relevante të brendshme dhe ndërkombëtare si dhe ekspertëve të fushave të përkatëse për t'i hetuar dhe ndëshkuar këto krime të cilat çdo ditë e më tepër janë në rritje.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, gjithashtu janë trajtuar raste nga praktika, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë punës së tyre praktike.

Për realizimin e këtij trajnimi janë angazhuar trajnues vendor dhe trajnues ndërkombëtarë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor si dhe zyrtar policor nga Inspektorati Policor i Kosovës.



Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet

Më 08 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi trajnimin me temë “Mbrojtja gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua procedura në kontestet e pengim posedimit dhe të drejtës së servitutit si dhe elementet e aktit të pengim posedimit dhe servitutit. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan afatet për mbrojtje gjyqësore në kontestet e pengim posedimit dhe të servitutet si dhe raste nga praktika gjyqësore lidhur me këto konteste. Në trajnim gjithanshëm u trajtua aspekti teorik dhe ai praktik që ka të bëjë me mbrojtjen gjyqësore nga pengim posedimi dhe servitutet.

Gjatë trajnimit u potencua se në procedurën që zhvillohet për kontestet për shkak të pengim

posedimit, si procedurë e posaçme kontestimore që është rregulluar me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata i jep mbrojtje gjyqësore personit të cilit i është marrë sendi nga posedimi apo të cilit i shkaktohen pengesa gjatë shfrytëzimit të tij. Me dispozitat ligjore të përmendura mundësohet rivendosja e shpejtë dhe efikase e gjendjes faktike të çrregulluar, ku shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengim posedimit nga gjykata do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe të përcjella me shembuj praktik.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore dhe të Gjykatës së Apelit, Departamenti i Përgjithshëm - divizioni civil, si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.



Program i Specializuar Trajnimi për Prokurimin Publik të Kosovës - Sesioni I

Më 15-16 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi sesionin e parë të trajnimit me temën “Program i Specializuar trajnimi për Prokurimin Publik në Kosovë”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të pjesëmarrësve në planifikimin e hetimit, përmbajtjen e planit të hetimit, ndjekjes, identifikimit të burimeve të informacionit si dhe grumbullimi i provave në mënyrë që hetimi dhe gjykimi i rasteve të keqpërdorimeve kur kemi të bëjmë me veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik të trajtohen në mënyrë profesionale dhe efikase.

Gjatë këtij sesioni trajnues dy ditore është trajtuar legjislacioni pozitiv rreth prokurimit publik, procedurat dhe fazat e prokurimit publik si dhe identifikimi i indikatorëve të korrupsionit

që lidhen me prokurimin publik. Vëmendje parësore iu kushtua legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë, procedurat e prokurimit publik dhe mënyra e funksionimit të platformës së prokurimit publik elektronik.

Në këtë kontekst u elaboruan rregullat për specifikimet teknike dhe dosja e tenderit, përpilimi i dosjes së tenderit dhe procesi i vlerësimit të një tenderi, njoftimi, nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratave publike. Trajnimi u fokusua në elaborimin e skemave korruptive dhe problemeve të ndërlidhura me mashtrim, falsifikim, skemat e kurdisjes së ofertave si dhe faktorët që ndikojnë në paraqitjen e këtyre veprave penale të korrupsionit në prokurimin publik.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



“Standardet vendore dhe ndërkombëtare në rregullimin e shpifjes & gjyq imitues”

Më 22-23 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë, në bashkëpunim me projektin “Përforcimi i ekspertizës gjyqësore mbi lirinë e shprehjes dhe medias në Evropën Juglindore - JUFREX, organizoj trajnimin me temë “Standardet vendore dhe ndërkombëtare në rregullimin e shpifjes & gjyq imitues”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me standardet vendore dhe ndërkombëtare në rregullimin e shpifjes.

Në ditën e parë të trajnimit u trajtua korniza vendore ligjore në Republikën e Kosovës duke u fokusuar në çështjet si: çka është efekti frenues dhe dekriminalizimi i shpifjes? A është gazetari person zyrtar? Kush është përgjegjës për shpifje? Barra e provës, Përgjegjësia për opinione dhe imuniteti parlamentar – deklaratat e dhëna në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa në trajtimin e kornizës vendore institucionale dominuan temat lidhur me atë se: Kush i rregullon mediat online dhe të shtypit? Kush i rregullon mediat audio-vizive? Mundësitë e ankesave kundër raportimeve mediale shpifëse dhe roli i gjykatave si dhe raste të shpifjes nga praktika gjyqësore.

Në fokus të trajnimit ishte edhe analizimi i dispozitave të nenit 10 të KEDNJ, konkretisht u elaborua natyra, rëndësia, efekti dhe fushëveprimi i të drejtës në lirinë e shprehjes, nga këndvështrimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shpifja, figurat publike në media, përgjegjësitë dhe sanksionet në gazetari, ndërhyrjet në lirinë e internetit dhe mbrojtja e aktivitetit të gazetarisë dhe medias në sistemin gjyqësor të Kosovës dhe në praktikat e GJEDNJ.

Ndërsa në ditën e dytë u vazhdua me trajtimin e standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për mbrojtjen nga shpifja, rastet kur janë palë figurat publike-individët privat, faktet-opinionet, barra e provës, lartësia e kompensimit të dëmit, imuniteti parlamentar, raportimi i fjalëve të tjerëve - intervistat-live, komentet shpifëse/fotografitë në mediat sociale, etj.

Gjithashtu në ditën e dytë pjesëmarrësit realizuan gjyq-imitues dhe përmes roleve të ndryshme arritën të zgjidhin rastin që ishte dedikuar shpifjes, e që u shtrua në formë detyre, ku përfshiheshin elementet e përgjegjësive së shtetit dhe sanksionet në gazetari dhe mbrojtja e aktivitetit në gazetari dhe media. Epilogu i gjyqit imitues ishte vendimmarrja lidhur me pretendimet se në vendimin e atakuar të gjykatës nacionale në GJEDNJ ka pas shkelje të nenit 10 të KEDNJ nga gjykata nacionale e shtetit palë të kësaj Konvente.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore, prokurorët e prokurorive themelore, dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror

Më 27-28 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë me mbështetjen e UNICEF-it, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, realizoi trajnimin nga drejtësia për fëmijë në aspektin civil “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror”.



Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për zbatimin e drejtë të legjislacionit nga ana e gjyqësorit për çështjet që i referohen procedurës gjyqësore për dhënien e mbrojtjes juridike për të drejtat e fëmijëve pa përkujdesje prindërore.

Në ditën e parë trajnimit është trajtuar nocioni dhe kushtet e adoptimit si formë e veçantë e mbrojtjes së fëmijëve, nevojat për themelimin e adoptimit, legjislacioni i zbatueshëm vendor dhe ndërkombëtarë tek adoptimi. Gjithashtu u

trajtuar dhe bashkëpunimi i gjykatës dhe i organit të kujdestarisë në procedurën e adoptimit si dhe vendimet e gjykatës për adoptimin.

Tutje trajnimi u fokusuan kryesisht tek format e organizuara shoqërore të përkujdesjes ndaj fëmijëve pa kujdes prindëror, dhe roli dhe bashkëpunimi i Qendrës për Punë Sociale me gjykatën në rastet e vendosjes së fëmijës në familjen tjetër.

Temat tjera që u trajtuar në këtë sesion ishin edhe kujdestaria si institut me karakter shoqëror, organi i kujdestarisë si organ kompetent për mbrojtje të drejtave të fëmijëve dhe mënyrat e ushtrimit të kujdestarisë. Në këtë pjesë po ashtu u diskutua në lidhje me ushtrimin, pezullimin, kufizimin dhe heqjen e të drejtës prindërore.

Trajnimi u realizua duke përdorur metoda të kombinuara të shpjegimi teorik dhe praktik, punë në grupe, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës, zyrtar të QPS nga regjioni i Prizrenit, zyrtarë të UNICEF, si dhe zyrtarë tjerë që merren me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Trajnimet e realizuara në Programin Fillestar

Akademia e Drejtësisë, me qëllim të përmbushjes së prgramit trajnues, ka vazhduar me realizimin e aktiviteteve të planifikuara në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, të cilin janë duke e vijuar 49 gjyqtarë të sapo emëruar.

Në kuadër të trajnimit teorik, janë zhvilluar aktivitetet si në vijim: nën-moduli “Procedurat e veçanta sipas KPPK” është realizuar përmes një (1) sesion trajnues në këtë periudhë, nën-moduli “Procedurat sipas mjeteve juridike” dy (2) sesione trajnuese, “Shpenzimet e procedurës dhe kërkesa pasurore juridike” një (1) sesion trajnimi, “Marrja dhe komunikimi i vendimeve dhe dërgimi i shkresave” një (1) sesion trajnimi. Gjithashtu, janë realizuar tre (3) sesione trajnimi nga nën-moduli “Shqyrtimi fillestar, i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor” ku ndër të tjera janë trajtuar: kundërshtimi i provave, kërkesa për hedhjen e aktakuzës dhe shqyrtimi i dytë, përgatitja dhe rrjedha e shqyrtimit gjyqësor.

Në kuadër të programit trajnues, gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe pesë (5) sesione trajnuese nga nën-moduli “E drejta civile” ku janë elaboruar këto tema: Krijimi dhe mbarimi i raporteve juridike, ndarja e fakteve juridike

dhe modifikimi i punëve juridike-kushti, afati posedimi, llojet, mbrojtja dhe shuarja e tij, të drejtat absolute dhe relative, përfaqësimi me prokurë (autorizimi), punët juridike të njëanshme dhe të dyanshme dhe punët juridike të pa vlefshme-nule. Ndërsa nga nën moduli “Procedura kontestimore – pjesa e parë” gjatë kësaj periudhe janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese dhe janë trajtuar: parimet e procedurës kontestimore, kompetenca, përbërja e rregullt e gjykatës dhe përjashtimi i gjyqtarit, palët në procedurën kontestimore si dhe parashtrësat dhe dërgimi i shkresave.

Gjatë muajit shkurt gjyqtarët e sapo emëruar në kuadër të trajnimit praktikë me institucionet jo gjyqësore kanë realizuar programe trajnimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil dhe Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktikë, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykata përkatëse, konform orarit të përcaktuar me program.



Trajnim praktik për gjyqtarët e sapoemëruar në Odën e Avokatëve të Kosovës

Më 05 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapoemëruar, ka realizuar trajnimin praktik në Odën e Avokatëve të Kosovës (OAK).



Qëllimi i trajnimit ishte që gjyqtarët e sapoemëruar të krijojnë një pasqyrë të qartë rreth rolit, strukturës, organizative, dhe sfidat me të cilat ballafaqohet OAK.

Fillimisht, u pasqyrua një historik i shkurtër rreth themelimit të OAK-së, korniza ligjore mbi të cilën vepron OAK, e pastaj misioni, detyrat, qëllimi dhe organizimi i saj, shërbimet për komunitetin, si dhe aktivitetet bashkëpunuese me institucionet tjera.

Gjatë vizitës u shtjellua edhe procedura e brendshme e shqyrtimit të ankesave që paraqiten në OAK, duke përfshirë edhe ankesat e gjyqësorit të drejtuara ndaj avokatëve, ose kallëzimet penale që janë bërë në drejtim të gjyqësorit, pastaj si merr vendim komisioni ndaj avokatëve që shkelin Kodin e Etikës, masat më të shpeshta që shqiptohen ndaj tyre, në rast mosrespektimi të Kodit të Etikës dhe ligjit. Po ashtu, u elaborua roli dhe funksionimi i Qendrës Trajnuese për Avokatë si dhe programet trajnuese që ajo ofron.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapoemëruar të shtetit gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnim praktik i gjyqtarëve të sapo emëruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Më datën 13-14 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, ka realizuar trajnimin praktikë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Trajnimi kishte për qëllim që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me kompetencat, përgjegjësitë

e KPMSHCK, procedurën e marrjes së vendimit, procedura para shqyrtimit të ankesës në, format e vendimmarrjes si dhe afatet dhe veprimet në kuadër të organit të punësimit.

Gjatë trajnimit u shtjellua korniza ligjore, dispozita që përcaktojnë procedurën dhe afatet

e ankimit brenda organit të punësimit dhe në KPMSHCK, procedurën dhe afatet e shqyrtimit të ankesës, format e vendimmarrjes, përgjegjësitë e personave përgjegjës dhe të institucioneve për zbatimin e vendimeve të KPMSHCK si dhe procedurën në rast të mos zbatimit të vendimit si dhe dispozitat e legjislacionit të ndërlidhur me funksionet dhe kompetencat e KPMSHCK.

Gjithashtu u potencua se si ushtrohet funksioni i monitorimit për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, sa janë realizuar vizita monitoruese, dhe si janë përgatitur raportet për institucionet publike të nivelit qendror dhe lokal në procedurën e monitorimit.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç ‘rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Trajnim praktik për gjyqtarët e sapo emëruar në Komisionin Rregullativ i Prokurimit Publik

Më 27 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar, në bashkëpunim me Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik ka realizuar trajnimin praktik në këtë institucion.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët e sapo emëruar të njoftohen me rolin, funksionin, përgjegjësitë e prokurimit publik elektronik, si dhe funksionet tjera të parapara me legjislacionin për prokurimin publik në Kosovë.

Gjatë trajnimit u shtjelluan procedurat dhe fazat e prokurimit publik, mënyra dhe mekanizmat e funksionimit të platformës së prokurimit publik elektronik, legjislacioni pozitiv rreth prokurimit publik, si dhe legjislacioni primar dhe sekondar që rregullon këtë fushë.

Gjatë vizitës u shtjellua edhe çështja e përpilimit të dosjes së tenderit dhe procesi i vlerësimit të një tenderi, njoftimi, nënshkrimi dhe ekzekutimi i kontratave publike. Pastaj, u elaboruan edhe vështirësitë dhe sfidat me të cilat ballafaqohet ky institucion në përmbushjen e përgjegjësisë, kur ka të bëjë me rastet e keqpërdorimeve, të veprat penale të kryera nëpërmjet prokurimit publik.

Trajnimi u realizua përmes shpjegimeve teorike dhe diskutimeve interaktive, me ç ‘rast gjyqtarët e sapo emëruar patën rastin të shtrojnë pyetje të ndryshme për çështjet që ishin në fokus të trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar, gjenerata e VI-të e PTF-së.



Aktivitetet nga Programi për Hulumtime dhe Publikime

Pranim dorëzimi i librave për bibliotekën e Akademisë

Me 15 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë ka pranuar si donacion 32 tituj të librave me 106 ekzemplarë nga misioni i UNHCR zyra në Prishtinë.



Koleksioni i librave nga UNHCR përfshinë fushën e të drejtës së refugjatëve dhe personave pa shtetësi të cilat janë botuar nga shtëpitë botuese me renome ndërkombëtare si Oxford University, Press Cambridge University, Routledge, Claredon Books, Taylor&Fracis, Wolf Legal Publishers, Edward Elgar Publishing, Bloomsbury Publishing, Martinus Nijhoff Publishers dhe Zed Books Ltd.

Me rastin e pranim dorëzimit të librave ishte i pranishëm shefi i Misionit të UNHCR-së, z. N L Narasimha Rao së bashku me tre përfaqësues tjerë si dhe Drejtori i Akademisë z. Valon

Kurtaj së bashku me stafin tjetër udhëheqës të programit dhe bibliotekës së Akademisë.

Shefi i. Misionit të UNHCR-së, z. N L Narasimha Rao ofroj gatishmëri për mbështetje të mëtutjeshme për Akademinë e Drejtësisë veçanërisht për lëmine e drejtës së refugjatëve qoftë përmes trajnimeve apo edhe zhvillimit të modulit për këtë fushë.

Drejtori i Akademisë shprehu falënderim dhe mirënjohje për UNHCR duke i siguruar që këto libra do të jenë në shërbim të gjyqtarëve dhe trajnuesve të Akademisë.

Në fund të kësaj ceremonie është nënshkruar dokumenti i pranim nga shefi i Misionit dhe Drejtori i Akademisë me qëllim të formalizimit të donacionit.



Aktivitetet tjera

Program intershipi i kandidatëve nga Shkolla Kombëtare e Magjistraturës së Francës -ENM

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes Akademisë së Drejtësisë dhe Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës – ENM, prej datës 29 janar deri me 16 shkurt 2018, dy kandidatë të kësaj shkolle kanë qëndruar në Kosovë në një program praktik të



trajnitimit.

Qëllimi i këtij programi qëndron në njoftimin e kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë të Francës, me sistemin gjyqësor në Kosovë, veçanërisht në ndjekjen, hetimin dhe gjykimin e veprave penale, si dhe zbatimin e dënimeve, çështjet gjyqësore civile me fokus në ato familjare, kontrata dhe përgjegjësitë, të kuptuarit e dimensionit ndërkombëtar të drejtësisë dhe të kuptuarit e sistemeve të huaja të trajnitimit të gjyqtarëve.

Akademia ka përgatitur agjendën e këtij programi intershipi e cila përmban trajnimin praktik që realizohet në gjykata dhe prokurori në mbështetje të gjyqtarëve/prokurorëve në cilësinë e mentorit si dhe janë organizuar takime me institucione tjera vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë. Zbatimi i këtij programi ka filluar me një takim në Akademinë e Drejtësisë, ku janë njoftuar në përgjithësi

lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, funksionet, përgjegjësitë si dhe programet që i zhvillon Akademia.

Në kuadër të agjendës së programit, kandidatët nga ENM kanë vazhduar trajnimin në Prokurorinë Themelore dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë, në mbështetje të një prokurori dhe dy gjyqtarëve njëri në çështje penale dhe tjetri në ato civile. Kandidatët kanë pasur mundësi që të ndjekin seanca të ndryshme lidhur me procedurën e hetimit, me njoftimin më të gjerë për sistemin gjyqësor, duke filluar nga veprimet e para që i ndërmerr gjyqtari lidhur me një lëndë, pastaj shqyrtimin fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, pranimin e fajësisë në procedurën paraprake, trajtimi i lëndëve me paraburgim, masat e fshehta në procedurën paraprake dhe zbatimin e dënimeve në Kosovë.

Po ashtu, gjatë këtij programi kandidatët kanë pasur rast të ndjekin seanca përgatitore dhe shqyrtim gjyqësor lidhur me kontestet civile, familjare, pronësore etj. Gjithashtu është prezantuar edhe përmbytja e vendimeve gjyqësore (aktgjykimeve dhe aktvendimeve), dhe në kuadër të kësaj ka qenë mundësia e krahasimit të legjislacionit të dy vendeve, krahasimi i përmbytjes së vendimeve gjyqësore si dhe shkëmbimi i përvojave në fushën gjyqësore. Në kuadër të agjendës është realizuar edhe një takim me dy gjyqtar të sapo emëruar që janë duke e ndjekur Programin e Trajnimit Fillestar në Akademi, me të cilët është diskutuar rreth sistemit gjyqësor në Kosovë si dhe kanë ndarë përvoja të ndryshme lidhur me aktivitetet që i realizojnë në kuadër të trajnitimit fillestar.



Kandidatet e ENM-së kanë realizuar edhe një vizitë në Qendrën Korrektues në Lipjan, ku nga zyrtarët e kësaj qendre janë njoftuar rreth rolit dhe mandatit të qendrës, strukturën e organizimit dhe funksionimit të saj si dhe kategoritë e personave që janë në mbajtje në këtë qendër korrektuese. Më tej së bashku me stafin e qendrës, vizituan ambientet e institucionit, duke parë në këtë formë, për së afërmi të gjitha mjediset me të cilat disponon Qendra Korrektuese në Lipjan, kushtet dhe aktivitetet që ajo ofron për personat që janë në mbajtje brenda saj si dhe trajtimi mjekësor dhe psikologjik i tyre.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime edhe me përfaqësues të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si, Gjykata Kushtetuese, gjyqtarë nga EULEX-i,

përfaqësues nga Projekti i Binjakëzimit në Këshillin Prokurorial të Kosovës, USAID-i, Këshilli i Evropës dhe GIZ-i.

Në përfundim të programit kandidatet e ENM kanë realizuar një takim përfundimtar në Akademi, me qëllim diskutimit të përshtypjeve të rreth organizimit të programit praktik, sa kanë arritur të njoh sistemin gjyqësor dhe prokurorial në Kosovë si dhe rekomandimet e tyre, për organizimin e programeve të ngjashme të përbashkëta në të ardhmen.

Kjo është gjenerata e katër me radhë e kandidatëve të Shkollës Kombëtare të Magjistraturës së Francës të cilët realizojnë këtë program.

“Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti”

Më 20 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi, dhe në rastet e dhunës në familje, në veçanti”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me trajtimin e barazisë gjinore në procedurë gjyqësore, në rastet e dhunës në familje në veçanti, duke trajtuar gjithanshëm aspektin teorik dhe atë praktik.

Në pjesën e parë të trajnimit u trajtua legjislacioni ndërkombëtarë dhe vendor për barazinë gjinore, dhuna në familje dhe format e shfaqjes së saj me fokus gjinor dhe urdhri për mbrojtje, kushtet për caktimin e urdhrin për mbrojtje si dhe masat për parandalimin e dhunës. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesës për urdhër mbrojtje, hartimi dhe arsyetimi i vendimit sipas specifikave të çështjes duke respektuar dispozitat ligjore, ekzekutimi i urdhrin për mbrojtje dhe pasojat për shkelje të urdhrin për mbrojtje.

Në trajnim u veçua se parimi bazë i procedurave gjyqësore në shoqëritë demokratike, ku garantohen të drejtat dhe liritë e njeriut, është barazia e palëve në procedura gjyqësore dhe parimi i barazisë gjinore. Në Republikën e Kosovës, barazia e palëve në procedurë është e

garantuar me Kushtetutë, me konventa ndërkombëtare dhe me ligjet e brendshme.

Gjithashtu u potencua se qëllimi parësor i Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje është parandalimi i dhunës në familje në të gjitha format e saj. Andaj për përmbushjen e këtij qëllimi ligji ka paraparë një mori masash mbrojtëse kundër dhunës në familje, siç janë: masat mbrojtëse të trajtimit psiko social, masat mbrojtëse të ndalimit të afrimit të viktimës së dhunës në familje, masa mbrojtëse e ndalimit të shqetësimit të personave të ekspozuar dhunës, masa mbrojtëse e largimit nga banesa, shtëpia apo hapësira tjetër e banimit, masa mbrojtëse e shoqërimit të viktimës së dhunës, masa mbrojtëse e trajtimit mjekësor nga varësia prej alkoolit dhe substancave psikotropike, masa mbrojtëse e marrjes së sendit dhe masat mbrojtëse pasurore të cilat u shpjeguan një nga një dhe në bashkëbisedim me pjesëmarrësit.

Në trajnim u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit duke përfshirë shpjegime teorike dhe të përcjella me shembuj praktik.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, prokurorët e prokurorive themelore, bashkëpunëtorët profesional të gjykatave dhe mbrojtësit e viktimave në Republikën e Kosovës.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**